REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 17/23
Datë/Datum. 23.01.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Idriz Cufaj	**12/01/2023**	**23/01/2023**	**Nr. 17/23**
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **06.01.2023**, OE " **PRO MEDICAL** " **SH.P.K.** - Ferizaj, ka parashtruar ankesë me nr: **17/23**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE " **MADEKOS** " **SH.P.K.** , lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**FURNIZIME MJEKËSORE PËR NEVOJAT E QKMF – së** " me nr. të prokurimit: **623-22-11331-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL – RAHOVECË.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**, lloji i kontratës: **furnizime,** vlera e parashikuar e kontratës: **15,400.00€.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Vlerësimi i aktivitet të prokurimit është në kundërshtim me Ligjit të Prokurimit Publik, nr.04/L-042 pra dispozitat e shkelura te LPP-se:

Neni 1- Qëllimi

Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi

Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Hyrje

AK-Komuna Rahovec ne aktivitetin e prokurimit **FURNIZIME MJEKËSORE PËR NEVOJAT E QKMF - LOT I Blerja e EKG per nevojat e QKMF-së dhe Lot II - BLERJA E DEFIBLATORIT MOBIL DHE STATIK**, AK ne aktivitetin e prokurimit te lartshënuar me datën 08.12.2022, Autoriteti Kontraktues ka bere Njoftimin mbi Vendimin e AK-se, ku për LOT I e ka shpërblyer me kontrate OE MADEKOS me çmim 8,990.00 €, kurse për LOT II - 2,999.00 € neve si Operator Ekonomik, kurse me datën 20.12.2022 AK për LOT I përsëri lenë fuqi vendimin e datës 08.12.2022 kurse për LOT II ndryshon B58 pra Vendim për LOT II **pa pasur asnjë kërkese për rishqyrtim** **për LOT II** ku neve na eliminon dhe rekomandon një OE tjetër për kontrata për LOT II pra në vendimin te cilin e ka marr AK me datën 20.12.2022 për LOT II bie ndesh me LPP sepse çdo LOTO është kontrate ne veti dhe një LOTO nuk mund te kthen ne ri-vlerësim nëse nuk ka pasur **kërkese për rishqyrtim** për LOT 2 pra e cila duhet te dorëzohet konform LPP Neni 108/A pra ky veprim i AK për LOT II është një anomali.

Pas kërkesës për rishqyrtim qe kemi bere ne si OE. PROMEDICAL për LOT I me date 13.12.2022, për arsye se ne si OE kemi qene me çmim me te lire me dokumentacion te përgjegjshëm, dhe me këtë kërkese për rishqyrtim AK-Komuna Rahovec, ka bere kthimin e lendes ne Rivlerësim, dhe me date 20.12.2022 ka bere vendimin e rivlerësimit, ku e ka rekomanduar për kontrate OE te njëjtë si ne Vendimin e parë për LOT I edhe pse OE i rekomanduar nuk ka qene konform FDT dhe LPP por përsëri AK e favorizon ketë OE kurse neve ne diskriminon me mënyre klasike dhe ne kundërshtime me LPP.

Dispozitat e shkelura te LPP-se për LOT I dhe LOT II

Neni 1- Qëllimi -E kundërshtojmë vendimin e Autoritetit Kontraktues ngase i njëjti është në kundërshti me nenin 1 te Ligjit për Prokurim Publik dhe paragrafin nuk ka marre ne konsiderate detyrimin.
AK në këtë rastin tonë ka shkelur Nenin 1 paragrafin 2 të LPP citim *"Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji"*

Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi- Ne Pro Medical nuk jemi trajtuar si të barabartë nga AK, sepse ene jemi duke u diskriminuar nga AK. Ne Pro Medical nuk është trajtuar si te barabarte nga AK dhe në kundërshtim me LPP jemi eliminuar edhe pse oferta jone ka qene ne harmoni me kriteret e tenderit, pasi kemi pasur qasje ne bazë vlerësimin edhe ekzaminimi kemi vërejtur se NJK ka favorizuar atë OE edhe pas nuk ka qene konfrom NJK dhe DT.

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve- AK nuk ka respektuar LPP gjatë vlerësimit të ofertës tonë. Arsyetime e eliminimit ndryshojnë nga vlerësimin te datës 08.12.2022, ku gjatë rivlerësimi AK ne vendim e datës 20.12.2022 ky arsyetimi i vetëm për eliminim është si me poshtë.

Kurse AK letrën ne standarde te datës 20.12.2022 ne letrën standarde për eliminim thotë se:

ARSYETIM:
Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:
Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1: Autorizim nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Dëshmia 1: Te dëshmohet se Operatori është i Autorizuar nga Prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi me numër te prokurimit si me lart. (me te dhëna detaje te kontaktit për prodhuesin adresa, websajti, numri i telefonit, emaili);

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, keni prezantuar një Autorizim nga prodhuesi, mirëpo i njëjti nuk e plotëson, kërkesën dhe dëshminë e përcaktuar në Dosjen e Tenderit nga AK, në këtë Autorizim mungon Numri i Prokurimit;

AK ne letrën standarde na jep një sqarim se (citim): Ne ofertën e juaj te dorëzuar, keni prezantuar një Autorizim nga prodhuesi , mirëpo i njëjti nuk e plotëson, kërkesën dhe dëshminë e përcaktuar ne dosjen e tenderit nga AK, ne këtë autorizim mungon numri i prokurimit.

Pra, lidhur me këtë ju sqarojmë se ne si Operator Ekonomik kemi te bashkangjitur Autorizimin nga Prodhuesi, dhe është e rëndësishme qe kërkesa e Dosjes përmbushet, sepse kërkohet sakte **Autorizim nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi,** ku ne si OE e kemi bashkangjitur këtë autorizim te prodhuesit mirëpo është përvjedhur dhe nuk e kemi shkruar numrin e prokurimit, por kjo nuk paraqet problem sipas Dispozitave Ligjore te LPP-se, sepse shume qarte e shpjegon edhe neni 59.4 ***(ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, cfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.***

Pra, bazuar ne këtë paragraf sqarohet shume qarte se kjo nuk ndikon ne aspektin material dhe janë lëshime te vogla pra minore qe AK duhet të merr parasysh këtë por edhe PSH duhet te ketë parasysh Neni 59.4 pike (ii) sepse është gabim minore.

AK për shkak te kursimit te buxhetit duhet te merr parasysh nenin 1 dhe 6 te LPP-se, sepse jemi OE me çmim me te lire dhe qëllimi i LPP-se është kursimi i buxhetit publik, e qe ne rastin konkret ju si AK nuk e keni kursyer buxhetin e Autoritetit Kontraktues, por po e dëmtoni me këto veprime.

Paragrafi 1 dhe 2 i nenit 6 te LPP-se thotë:

1. *Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.*

2. *Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës*

Bazuar ne këto dispozita ligjore qe AK i ka shkelur duhet te veproj ne harmoni me kriteret e FDT-se dhe pasi qe jemi me çmimin me te lire te rekomandohemi për kontrate, e jo te diskriminohemi ashtu siç na ka diskriminuar AK-Komuna Rahovec, sepse kjo ka mund shume lehte te sqarohet nëse ka ndonjë paqartësi, por kjo deklarate ka qene pjese e dosjes se tenderit dhe është shume e qarte nëse AK e sheh sipas ligjit dhe nëse e sheh sipas tendencave dhe inateve, kjo nga AK llogaritet si e pariparuesheme.

Pra, AK e ka shpërblyer me kontrate OE me çmim 8,900.00 €, qe është 1,000.00 € me shtrenjte se oferta jone dhe me këtë AK ka bere shkeljen e dispozitave te LPP-se, konkretisht shkeljen e nenit 59 te LPP-se, dhe nenit 7 te LPP-se, ku komisioni ka qene i ndikuar nga Zyrtari Pergjegjes i Prokurimit, i cili ne baze te paragrafit 8 te nenit 25 te LPP-se për shkeljet e tilla duhet te merren masa qe ti konfiskohet Certifikata, sepse është përgjegjësi e Zyrtarit Përgjegjës te Prokurimit qe te gjithë ofertuesit duhet te trajtohen sipas nenit 7 te LPP-se, qe thotë citim: ***"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veproj në mënyrë transparente".***

*Po ashtu paragrafi 2 i nenit 24 te LPP-se thote:**"Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".***

Gjate qasjes qe kemi pasur ne dokumentet e tenderit te OE rekomanduar për LOT I AK ka bere shkeljen e nenit 59 te LPP pra AK gjatë vlerësimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë për LOT I , AK nuk e ka respektuar Neni 59 gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve sepse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kriteret administrative lidhur me kërkesat dhe kriteret në DT, dhe ne baze te nenit 59 të LPP OE i rekomanduar për kontratë duhej të eliminohej nga ky aktivitet i prokurimit jo te rekomandohet për kontratë OE i rekomandua nuk ka dorëzuar dokumente si me poshtë:

- *Autorzim nga prodhuesi per LOT I dhe LOT II.*
- *Operatori Ekonomik është i obliguar të paraqesë një deklarata me shkrim me të cilën garanton se pajisje e ofruara do të jenë me garanci 12 muaj*

AK për çudi AK e refuzon oferton kurse rekomandon për kontrate OE i cilin nuk është konfrom LPP ne aspektin administrative sepse mungoj dokumente si me lart.

AK nuk ka respekton Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi sepse AK ka përdoruar standarde të dyfishta gjatë vlerësimin te ofertës, kurse kundër OE të rekomanduar për kontrate nga AK nuk keni bërë vlerësim fare pra qëllimi primar i AK ka që eliminim e kompanisë tonë dhe jo të bëjë vlerësim konfrom LPP.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës- Gjatë këti aktiviteti të prokurimit AK nuk e ka respektuar Neni 60 Paragrafi 1 dhe alinenë 1.1 Sepse kriter për dhënie të kontratës publike ka qenë alineja 1.1 e paragrafit 1 pra alineja 1.1 citim "*tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët*" ne si OE i eliminuar kemi plotësuar kriteret në dosjen e tenderit dhe rrjedhimisht oferta e jonë ka qenë e përngjeshmë dhe me favorshme ne aspektin financiare.

Shenime shtesë për LOT II .

AK-Komuna Rahovec ne aktivitetin e prokurimit FURNIZIME MJEKËSORE PËR NEVOJAT E QKMF – Lot II – BLERJA E DEFIBLATORIT MOBIL DHE STATIK

AK ne aktivitetin e prokurimit te lartshënuar për LOT 2 – 2,999.00 € neve si Operator Ekonomik pra OE Pro Medical.

Por AK-Komuna Rahovec, ka bere kthimin e lendes ne Rivlerësim, pa pasur asnjë kërkese për rishqyrtim për LOT II, dhe me date 20.12.2022 ka bere vendimin e rivlerësimit, ku neve si OE na eliminon dhe e shpërblen me kontrate për LOT II – një OE tjetër.

Shtrohet pyetja:

Si është e mundur AK te kthen lenden ne rivlerësim, pa asnjë kërkese për rishqyrtim?

Si ka mundësi qe AK e rikthen ne rivlerësim një LOTO kur nuk ka pasur kërkese për rishqyrtim sepse kjo është anomali.

AK duhet te ketë parasysh se secila LOTO është kontratë me veti dhe AK nuk mund te anuloni apo rivlerësoni një LOT pa pasur Kërkesë pe Ri-shqyrtim siç ka vepruar AK për LOT II i cili veprim bie ndesh me LPP Neni Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve sepse asnjë OE nuk ka dorëzuar kërkese për rishqyrtim pra veprimi i AK bie ndesh me gjithashtu me Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi sepse ne si OE jemi diskriminuar nga AK ne mënyre klasike pra kjo është anomali te ri-kthen ne ri-vlerësim një LOT pra LOT II pa pasur kërkese për rishqyrtim pra ju lutem shikoni emali qe kemi dërguar tek AK pra me datën 22.12.2022 dhe 13.12.2022 pra AK nuk kthen përgjigjej fare lidhur me pyetje tone sepse nuk ka pasur kërkese për rishqyrtim për LOT II pra AK pa bazuar baze ligjore vepron pra kjo është anomali sepse ri-vlerësimi i një LOTO pa pasur kërkese për rishqyrtim për LOT II kjo është një veprim abuzues i AK me LPP.

VENDIMI

I. APROVOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim dhe lënda te kthehet ne

II. RIVLERESIM, dhe gjate fazës se rivlerësimit AK te respekto LPP pra Neni 59.4 (ii),

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/ ***janë te njëjta me pretendimet ankimore te parashtruara ne Kerkesen per rishqyrtim te dorezuar te AK.***

KRITERET PËR VLERËSIM

Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjn me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen pretendimet ankimore.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe professional Kërkesa 1 Autorizim nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Dëshmia 1 Te dëshmohet se Operatori është i Autorizuar nga Prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi me numër te prokurimit si me lart, (me te dhëna detaje te kontaktit për prodhuesin adresa, websajti, numri i telefonit, emali)

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
(Të përshkruhet vetëm vlërësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).
Operatori Ekonomik ankues "PRO MEDICAL " SH.P.K. nga komisioni vlerësues është ofertë e papërgjegjshme .

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyjeve në vijim:

ARSYETIM:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kapaciteti teknik dhe professional:

Kërkesa 1: Autorizim nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1: Te dëshmohet se Operatori është i Autorizuar nga Prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi me numër te prokurimit si me lart, (me te dhëna detaje te kontaktit për prodhuesin adresa, websajti, numri i telefonit, emali);

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, keni prezantuar një Autorizim nga prodhuesi, mirëpo i njëjti nuk e plotëson, kërkesën dhe dëshminë e përcaktuar në Dosjen e Tenderit nga AK, në këtë Autorizim mungon Numri i Prokurimit;

Dokumenti një fjale nuk mund te kërkohet ne baze te Nenit 72, paragrafi 3. i cili përcakton si në vijmë: *Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive*, **andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së, i cili përcakton si në vijmë:** *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*

OE "MADEKOS " SH.P.K. është ofertë e rekomanduar për kontratë Pjesa 1 &2

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Nuk ka marre eksperti shqyrtues informacione shtese

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).
Është palë e interesit

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).
Nuk ka vendime te më hershme per kete aktivitet te prokurimit

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).
Nuk kemi devijim nga praktikat e me hershme

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES " ARHIKO. ING O.P."

Përgjigje në Pretendimi nr.1 për Pjesën 1.

Pretendimi ankimor i OE ankues se është eliminuar pa të drejt nga Autoriteti Kontraktues sipas mendimit të ekspertit shqyrtues nuk qendrojn pasi që Operatori Ekonomik ankues nuk i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Në këtë dosje të tenderit dhe të njoftimi për kontrate te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 eshte kerkuara si ne vijim:
Kërkesa 1 Autorizim nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi ndersa si deshmi
Dëshmia 1 Te dëshmohet se Operatori është i Autorizuar nga Prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi me numër te prokurimit si me lart, (me te dhëna detaje te kontaktit për prodhuesin adresa, websajti, numri i telefonit, emali).

Operatori ekonomik ankues nuk e ka plotësuar këtë kriter konform kerkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë pasi që Autorizimi nuk është konform kerkesës së Autoritetit Kontraktues pasi që është kërkuar Autorizim me numër të prokurimit ndërsa Operatori Ekonomik Ankues në autorizimin e dorëzuar në ofertë është pa numër të prokurimit që në fakt nuk i plotëson kerkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Autorizimi i leshuar nga " SINOHERO" për Operatorin Ekonomik ankues është i leshuar me datë 23/07/2021 dhe nuk specifikohet askund numrin e aktivitetit të prokurimit ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë nga Autoriteti Kontraktues.
Autoriteti Kontraktues ka bërë vlersimin e ofertave konform nenit 59 të Ligjit i Prokurimit Publik. *Duke ju referuar kriterit të sipër permendurë me lartë,* mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është **i pa bazuar për Pjesen 1.**

Përgjigje në Pretendimi nr.2 për Pjesën 2.
Pretendimi ankimor i OE ankues që ishte i rekomanduar për kontratë për Pjesën 2 dhe pas kerkesës për rishqyrtim që është bërë për Pjesën 1 duke ju aprovuar pjesërishte të bazuar, Autoritti Kontraktues ka berë anulimin e vendimit duke mos specifikuar se për cilen pjesë është aprovuar pjesërishte kerkesa për rishqyrtim.

Autoriteti Kontraktues sipas mendimit të ekspertit shqyrtues ka bere gabim pasi qe deri sa nuk ka pasur kerkese për rishqyrtim për Pjesën 2 dhe e kthen në terësi të gjitha pjesët në rivlersim.
Duke marre parasysh deshmit dhe dokumentet e dorezuar në ofertën e Operatorit Ekonomik ankues dhe situata me të cilin është tani lënda edhe po të kthehet në rivlersim situata do te jetë e njejtë pasi që Operatori Ekonomik ankues nuk i plotëson të gjitha kriteret e kerkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë pasi që Autriteti Kontraktues e ka eliminuar për autorizim.

Në këtë dosje të tenderit dhe te njoftimi per kontrate te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 eshte kerkuara si ne vijim:
Kërkesa 1 Autorizim nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi ndersa si deshmi
Dëshmia 1 Te dëshmohet se Operatori është i Autorizuar nga Prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi me numër te prokurimit si me lart, (me te dhëna detaje te kontaktit për prodhuesin adresa, websajti, numri i telefonit, emali).

Autorizimi i leshuar nga " SHENZEN COMEN MEDICAL INSTRUMENTS CO.LTD" per Operatorin Ekonomik ankues eshte i leshuar me date 12-11-2021 ku nuk eshte specifikuar numri i aktivitetit te prokurimit ashtu sië eshte kerkuar ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin per kontrate pasi qe kerkesa ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin per kontrate kane qe te kjarta se ne autorizime duhet te shenohet numri i aktivitetit te prokurimit, (me te dhëna detaje te kontaktit për prodhuesin adresa, websajti, numri i telefonit, emali) ku asnje nga te dhenat e kerkuara nga nuk jane te perfshire ne autorizimin e dorezuar nga Operatori Ekonomik ankues.

Edhe Autorizimi i leshuar nga " SINOHERO" për Operatorin Ekonomik ankues është i leshuar me datë 23/07/2021 dhe nuk specifikohet askund numrin e aktivitetit të prokurimit ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë nga Autoriteti Kontraktues.

SINOHERO

Document No. :
Date: 2021-07-23

To whom it may concern,

LETTER OF AUTHORIZATION

We, SINO-HERO (Shenzhen) Bio-Medical Electronics Co., LTD., manufacturer of patient monitor (M8,M5,M3,iS15Pro,iS15,iS12,iS10Express,iS10,iS,mTouch9,mTouch8,mTouch7,mTouch6,S90express,S90, S80,S60Vista,H8,H5),electrocardiograph(SE1209,SE1208,SE1200Lite,SE608,SE600,SE509,SE508),pump(SH-609,SH-509i,SH-608),Ultrasound(S990plus & lite),S880Prime,S550,Pitra6),fetal monitor(eM6,eM8,eM9) and home care product(S6,S8,S9,SM80), certify thatPro medical, with business office at Kadri Zeka,Ferizaj,Kosovo is our authorized distributor in Kosovo.

We hereby authorize Pro medical to market and service, or submit bids, subsequently negotiate and sign the Contracts with the products mentioned above.

As the manufacturer, SINO-HERO guarantees our products against defects in materials and workmanship, and provide services based on the standard terms and conditions of SINO-HERO 's warranty policy.

This authorization is valid till 2023/07/23 from the date of issuance, and it is subject to termination by SINO-HERO to any or all Products at any time upon thirty (30) days prior written notice.

The legal effectiveness of this Letter of Authorization is subject to the Sales Contract. SINO-HERO shall not be responsible for any liabilities arising from or in connection with the covenants or agreements entered into by and between the JBC LT MEDICAL EQUIPMENT AND SUPPLIES TRADING and any other person and/or body corporate.

Very truly yours,

深圳市中意生物电子有限公司
Tel: +86-755-26408641
Fax: +86-755-26420644
Email: sales@sinoheromed.com
Web: www.sinoheromed.com

SINOHERO

Ren Lin | 2021/07/06

General manager

SINO-HERO (Shenzhen) Bio-Medical Electronics Co., Ltd.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE " PRO MEDICAL " SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit " Furnizime Mjekesore për nevojat e QKMF-së ", me numër të prokurimit: 643-22-11331-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal - Rahovecë.

COMEN SHENZHEN COMEN MEDICAL INSTRUMENTS CO.,LTD

MANUFACTURER'S AUTHORIZATION

We undersigned SHENZHEN COMEN MEDICAL INSTRUMENTS CO.,LTD do hereby confirm that Company PRO MEDICAL SH.P.K. is duly authorized to bid as tender in the territory of Kosovo

Therefore, they are authorized to provide, sell, distribute and install our products, medical equipment, in the territory of Kosovo

The Company PRO MEDICAL is also authorized to take care of the after-sale service

Date: 12-11-2021
Name: Ethan Han
Stamp and signature:

Ethan Han

Tel: +86-755-26418879 Fax: +86-755-26431232 http://en.comen.com info@comen.com

Duke ju referuar kriterit të sipër permendurë me lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është **i pa bazuar për Pjesen 2.**

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e Operatorit Ekonomik " PRO MEDICAL " SH.P.K. **të refuzohet si e pa bazuar**, dhe rekomandon **që të mbetet në fuqi** Vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – PRO MEDICAL. SH.P.K..